UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 16, datë 26.7.2023

PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2023 DHE MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2023

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 26 dhe nenit 51, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJMË:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2023, sesioni i dytë, të jenë:
   a) Gjuhë e huaj 21 gusht 2023;
   b) Gjuhë shqipe dhe letërsi 25 gusht 2023;
   c) Matematikë 30 gusht 2023;
   ç) Provimi me zgjedhje 4 shtator 2023.
2. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë, të jenë:
   a) Gjuhë e huaj 21 gusht 2023;
   b) Gjuhë shqipe dhe letërsi 25 gusht 2023;
   c) Matematikë 30 gusht 2023;
   d) Provim i teorisë profesionale të integruar 4 shtator 2023.
3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2023 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni dytë, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore.
4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2023 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë:
   a) fillojnë në orën 10:00;
   b) zgjasin 2 orë e 30 minuta;
   c) testet hartohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
5. Në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2023 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë, marrin pjesë:
   a) maturantët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2023 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i parë;
   b) maturantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2022–2023 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 11 gusht 2023;
   c) maturantët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2023, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale në vitin 2023, sesioni i parë;
   ç) maturantët/kandidatët që kanë kryer njohjen dhe njësimin e diplomës së arsimit të mesëm të lartë dhe kanë detyrime të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023.
6. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja "c" dhe "ç", të këtij udhëzimi, të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose në shkollën që u cakton zyra vendore e arsimit parauniversitar (ZVAP).
7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja "b", "c" dhe "ç", të këtij udhëzimi, të plotësojnë formularin AlZ, për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë.
8. Maturantët/kandidatët me aftësi të kufizuara do të zhvillojnë provimet e Maturës Shtetërore bazuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 49, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

9. Bazuar në memorandumin e bashkëpunimit/mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet MAS-it dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Italisë, për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane testi i provimit "Gjuhë dhe letërsi italiane":

a) përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe do të dorëzohet në QSHA;

b) zhvillohet me gojë, në shkollë, në datën 18.8.2023;

c) zhvillohet me shkrim në mjedisin e provimit të maturës shtetërore, në datën 21.8.2023;

d) rezultati i provimit gjuhë e huaj (D3), llogaritet sipas përcaktimeve të memorandumit të bashkëpunimit/mirëkuptimit, të përmendur në këtë pikë.

10. Drejtori i institucionit arsimor parauniversitar të dërgojë zyrtarisht në ZVAP listën e maturantëve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2023, dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë, deri më datë 15 gusht 2023. Drejtori i ZVAP-së ta dërgojë këtë listë në QSHA, në datën 15 gusht 2023.

11. Provimet të zhvillohen të përqendruara. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) përcakton qendrat e provimeve, duke u bazuar në numrin e maturantëve dhe në largësinë nga qendra e provimit.

12. ZVAP-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare, të marrin masa për njoftimin e maturantëve për datat, qendrën dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e detyruara, dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2023, dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë.

13. Drejtori i DPAP-së, brenda datës 14 gusht 2023, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe MAS-in për qendrat dhe mjediset ku do të zhvillohen provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2023, sesioni i dytë dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2023, dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë.

14. Monitorimi i procesit të Maturës Shtetërore 2023 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MAS-it dhe të institucioneve të varësisë.

15. Shpenzimet e përfaqësuesve të MAS-it në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2023 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë, të mbulohen nga institucionet ku janë të punësuar.

16. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj